



Datë: 28.03.2025

Numër protokolli: 2124/2025

A.nr.242/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani-Kryetar, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Çlirim Zeka në cilësinë e procesmbajtësit ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.242/2025 të datës 29.01.2025 të parashtruar nga ankuesi G.E., kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “*Kompensim Material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 28.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.242/2025 e datës 29.01.2025 e parashtruar nga ankuesi G.E.

II. Detyrohet Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme, që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi dhe në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm, ankuesit ti bëjë kompensimin e funksionit shtesë dhe atë për periudhën, sipas mbledhjeve të mbajtura të dëshmuara me procesverbal dhe nënshkrime të pjesëmarrjes.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me pikin II të diapozitivit.

A r s y e t i m

Ankuesi G.E. (*tutje referuar vetëm* ankuesi), më datë 29.01.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 648/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ndaj vendimit të Njësisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme të datës 16.01.2025, me pretendimin ankimor për arsye të mos kompensimit material si anëtarë i Komitetit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme për mbledhjet e mbajtura, i njëjti kërkon që ti aprovohet ankesa dhe të

detyrohet Ministria e Punëve të Brendshme ti aprovojë kërkesat e parashtruara për kompensim për mbledhjet e mbajtura të Komitetit të Auditimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 12.02.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa Këshilli më datë 10.03.2025 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Punëve të Brendshme me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë vendimin me numër VK/2025 me datë 13.03.2025 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankuesit edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 648/2025 të datës 29.01.2025 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Letërnjoftim i G.E.; Ligji Nr.06/L-021 për kontrollin e brendshëm të financave publike; Udhëzim administrativ MF-Nr.01/2019 për themelimin dhe funksionimin e komitetit të Auditimit në subjektin e sektorit Publik; Qarkore rreth zbatimit të Rregullores QRK Nr.10/2023 për kompensimin për funksionin shtesë i datës 22.03.2023; Rregullore QRK 10/2023 për kompensimin për funksionin shtesë; Vendim për themelim të komitetit për Auditimit të Brendshëm në MPB me nr.0790/2021 i datës 13.12.2021; Vendim i Njësisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme me numër protokolli 51 i datës 16.01.2025; Vendim i KPMSHCK me numër protokolli 6789/2024 i datës 16.12.2024; Lista e pjesëmarrësve e datës 15.03.2023; Mbledhja e Komitetit të Auditimit e mbajtur me datë 16.05.2023; Mbledhja e Komitetit të Auditimit e mbajtur me datë 22.08.2023; Mbledhja e Komitetit të Auditimit e mbajtur me datë 27.12.2023; Mbledhja e Komitetit të Auditimit e mbajtur me datë 22.04.2024; Lista e pjesëmarrësve Komiteti i Auditimit e datës 23.07.2024; Mbledhja e Komitetit të Auditimit e mbajtur me datë 10.09.2024; Mbledhja e Komitetit të Auditimit e mbajtur me datë 16.10.2024; Vendim i KPMSHCK me numër protokolli 1078/2024 i datës 26.02.2024; Akt Emërim i G.E. i datës 17.07.2020; Kërkesë për kompensim me nr. protokolli 1132 i datës 12.09.2024; Kërkesë për kompensim me nr. protokolli 1128 i datës 27.08.2024; Kërkesë për kompensim me nr. protokolli 1468 i datës 21.10.2024; Kërkesë për përgjigje në ankesë i datës 12.02.2025; Përgjigje në ankesë i datës 10.03.2025; Përkshkrimi i detyrave të punës i datës 16.06.2015; Fletëkthesë; Kërkesë për kompensim me nr. protokolli 1132 i datës 12.09.2024; Vendim për shtyrje të afatit i KPMSHCK me numër protokolli 1702/2025 i datës 13.03.2025;

Duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankesa e ankuesit **është e bazuar, sepse:**

Nga shkresat e lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se sipas Akt Emërimit të datës 17.07.2020 rezulton se ankuesi është i punësuar në pozitën Zyrtar i lartë për menaxhimin e kontratave në Divizionin për Menaxhimin e Kontratave në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Kolegji i Këshillit fillimisht ka konstatuar se ankuesi kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 24.10.2024. Ndërsa Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka nxjerr vendimin me numër protokolli 6789/2024 me datë 16.12.2024 përmes të cilit ka detyruar Udhëheqësin e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të nxjerr akt administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi lidhur me shqyrtimin e kërkesës për kompensim me Nr. Protokolli 1128 të datës 27.08.2024, kërkesës për kompensim me Nr. protokolli 1132 të datës 12.09.2024 dhe kërkesës për kompensim me Nr. protokolli 1468 të datës 21.10.2024 që ndërlidhet me kërkesën e ankuesit.

Ndërsa Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme ka nxjerr vendimin me protokolli 51 me datë 16.01.2025 me të cilin shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me kërkesën e nëpunësit G.E.

Tutje sipas shkresave të lëndës Kolegji i Këshillit ka gjetur se me Vendimin Nr.0790/2021 të datës 13.12.2021 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ankuesi është caktuar anëtarë i Komitetit të Auditimit të Brendshëm në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, dhe se sipas provave të lëndës Komiteti në fjalë ka mbajtur takime me datë 15.03.2023, 16.05.2023, 22.08.2023, 27.12.2023, 22.04.2024, 23.07.2024, 10.09.2024 dhe 16.10.2024.

Ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ndaj vendimit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme të datës 16.01.2025, me pretendimin ankimor për arsye të mos kompensimit material si anëtarë i Komitetit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme për mbledhjet e mbajtura, i njëjti kërkon që ti aprovohet ankesa dhe të detyrohet Ministria e Punëve të Brendshme ti aprovojë kërkesat e parashtruara për kompensim për mbledhjet e mbajtura të Komitetit të Auditimit.

Në kuptim të së drejtës së nëpunësit civil në kompensim për funksion shtesë, dhe shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji ju referua Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, gjegjësisht:

-Nenit 35: *Kompensimet që mund të përfitohen në bazë të këtij ligji janë: 1.1. kompensimi për kujdestari; 1.2. kompensimi për punë gjatë natës dhe jashtë orarit të punës; 1.3. kompensimi për punë gjatë fundjavës dhe ditëve të festave zyrtare; 1.4. kompensimi për udhëtime dhe shpenzimet e përfaqësimit; 1.5. kompensimi për funksionin shtesë; 1.6. kompensimi për anëtarët/ët e shërbimit të jashtëm; dhe 1.7. kompensimi për stafin tjetër të administratës që punojnë jashtë vendit.*

-Nenit 38: 1.Kur zyrtaret/ët publik, sipas legjislacionit në fuqi emërohen/caktohen që të shërbejnë në një bord, komision profesional apo organ tjetër publik që kërkon ekspertizë profesionale dhe përbën funksion shtesë për zyrtaren/in, ky/kjo zyrtar/e publik/e ka të drejtën e kompensimit shtesë për këtë funksion. 2. Kompensimi sipas pikës 1. të këtij neni nuk nënkupton detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga pozita të cilën e mban zyrtarja/i publike, përfshirë këtu edhe pjesëmarrjen në komisione dhe/apo organe të tjera të themeluara brenda institucionit. 3.Kompensimi sipas këtij neni bëhet në masën tridhjetë për qind (30%) për kryetaren/in dhe njëzet për qind (20%) për anëtarët/ët, të pagës bazë së zyrtares/it kryesor administrativ të institucionit në të cilën themelohet bordi, komisioni profesional apo organi tjetër publik. 4. Kompensimi i parashikuar në këtë nen, në rastin kur bordi, komisioni profesional apo organi tjetër publik mblidhet së paku një (1) herë në muaj, përfitohet çdo muaj, me kusht pjesëmarrje në mbledhje. 5. Kompensimi i parashikuar në këtë nen, në rastin kur bordi, komisioni profesional apo organi tjetër publik mblidhet më rrallë se një (1) herë në muaj, kompensimi përfitohet për çdo mbledhje, me kusht pjesëmarrje në mbledhje. 6. Qeveria, me propozim të ministrisë përgjegjëse për administratë publike dhe pas pëlqimit nga ministria përgjegjëse për financa, me akt nënligjor miraton kriteret për përfitim të këtij kompensimi.

Po ashtu, Kolegji iu referua edhe Rregullores (QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin për Funksione Shtesë, me theks të veçantë:

- **Nenit 4**, paragrafët 1 dhe 2, ku përcaktohet se: *Kompensimi për funksionin shtesë 1. Zyrtari publik i cili emërohet/caktohet që të shërbejnë në një bord, komision profesional apo organ tjetër publik që kërkon ekspertizë profesionale dhe përbën funksion shtesë për këtë funksion. 2. Kompensimi sipas pikës 1 të këtij neni nuk nënkupton detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga pozita të cilën e mban zyrtari publik, përfshirë këtu edhe pjesëmarrjen në komisione dhe/apo organe të tjera të themeluara brenda institucionit...*

-**Nenit 5**, paragrafi 2, ku parashihet se: 2. Përrjashtimisht, kompensimi për funksionin shtesë mund të përfitohet kur plotësohen në mënyrë kumulative kriteret e mëposhtme: 2.1. **themelimi i Komisionit/Bordit parashihet në ligj apo akt nënligjor;** 2.2. **përfshirja në komision përbën funksion shtesë për zyrtarin publik;** 2.3. **funksioni nuk bënë pjesë tek detyrat e obligueshme të pozitës të cilën zyrtari publik e mbanë;** 2.4. **përfshirja në Komision kërkon ekspertizë profesionale të cilën zyrtari e posedon;** 2.5. **komisionet/bordet të cilat kanë kompetenca Vendim-marrëse në procedurë administrative;** 2.6. **komisioni/bordi nuk themelohet nga institucioni ku zyrtari publik është i punësuar...**” si dhe

-**Nenit 7**, ku përcaktohet se: 1. Kompensimi sipas këtij neni bëhet në masën tridhjetë për qind (30%) për kryetarin dhe njëzet për qind (20%) për anëtarët, të pagës bazë së zyrtarit kryesor administrativ të institucionit në të cilën themelohet bordi, komisioni profesional apo organi tjetër publik. 2. Kompensimi i parashikuar në këtë nen, në rastin kur bordi, komisioni profesional apo organi tjetër publik mblidhet së paku një (1) herë në muaj, përfitohet çdo muaj, me kusht pjesëmarrje në mbledhje. 3. Kompensimi i parashikuar në këtë nen, në rastin kur bordi, komisioni profesional apo organi tjetër publik mblidhet më rrallë se një (1) herë në muaj, kompensimi përfitohet për çdo mbledhje, me kusht pjesëmarrje në mbledhje.

Po ashtu Kolegji i Këshillit iu referua Qarkores rreth zbatimit të Rregullores (QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin për Funkcionin Shtesë të nxjerrë nga Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme me numër protokolli 356 të datës 22.03.2023 ku në pikën 8 përcaktohet se: *Në raste kur përbërja e Komisioni/Bordi është nga institucione të ndryshme, kryesuesi dhe të gjithë anëtarët e Komisionit/Bordit kanë të drejtë të kompensohen, duke përfshirë edhe anëtarët të cilët janë të punësuar në institucionin që ka nxjerrë vendimin për themelimin e Komisionit/Bordit. Kjo vlen për Komisione/Borde që janë tërësisht ndryshe nga përshkrimi i detyrave të punës si p.sh. Komiteti i Auditimit të Brendshëm, Komisioni për Vlerësim të Dëmeve të Shkaktuara nga Fatkeqësitë Natyrore, Komisionet e ndryshme të themeluara nga Qeveria me përbërje të institucioneve tjera. Ky kompensim nuk vlen për të gjitha Komisionet edhe sikur përbërja e tyre të jetë me zyrtarë të institucioneve të ndryshme, nëse në mënyrë kumulative nuk janë plotësuar kriteret e pikës 3 të kësaj Qarkore.*

Nisur nga kuadri ligjor si më lartë si dhe duke u bazuar në provat materiale të çështjes, Kolegji vlerëson së janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit për kompensim të funksionit shtesë, për faktin se në rastin konkret janë plotësuar të gjitha kërkesat ligjore për kompensim të funksionit shtesë, rrjedhimisht, themelimi i Komisionit për Komitetin e Auditimit të Brendshëm është përcaktuar me nenin 6 të Ligji Nr. 03/L-128 për Auditimin e Brendshëm dhe Udhëzimin Administrativ MF-Nr. 01/2019 për Themelimin dhe Funkcionimin e Komitetit të Auditimit në Subjektet e Sektorit Publik, angazhimi në këtë Komitet kërkon ekspertizë profesionale dhe se duke qenë se ankuesi mbanë pozitën e punës Zyrtar i lartë për menaxhimin e kontratave në Divizionin për Menaxhimin e Kontratave në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, atëherë, angazhimi i tij si anëtarë i Komitetit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme, nuk bënë pjesë të detyrat e obligueshme të ankuesit.

Përkitazi, me kriterin e përcaktuar me nenin 4, pika 2.6 të Rregullores (QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin për Funksione Shtesë, se **komisioni/bordi nuk themelohet nga institucioni ku zyrtari publik është i punësuar..**, Kolegji thekson faktin se një kërkesë e tillë ligjore nuk përcaktohet më Ligjin Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, andaj, në respektim të parimit të hierarkisë së akteve ligjore, Kolegji shqyrtoj dhe vendosi për këtë çështje juridike-administrative në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, si akt më i lart juridik, në raport me Rregulloren (QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin për Funksione Shtesë.

Për më tepër, lidhur me kriterin e emërimit të anëtareve me ekspertizë profesionale në Komitetin e Auditimit të Brendshëm, Kolegji vë në dukje faktin se Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme, është përgjegjës për respektim të dispozitave ligjore të nenit 6 të Ligjit Nr.03/L-128 për Auditimin e Brendshëm dhe Udhëzimit Administrativ MF-Nr. 01/2019 për Themelimin dhe Funkcionimin e Komitetit të Auditimit në Subjektet e Sektorit Publik, fushë kjo jashtë juridiksionit material të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Siç u tha më sipër, Kolegji në mbështetje të nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, rrjedhimisht, aprovoj ankesën si të bazuar dhe detyroj Sekretaren e Përgjithshme të Ministrisë së

Punëve të Brendshme, që ankuesit ti bëjë kompensimin e funksionit shtesë lidhur me angazhimin si anëtarë i Komitetit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në pajtim me mbledhjet e mbajtura dhe atë nga dita e emërimit të ankuesit në cilësi të anëtarit të Komitetit përkatës deri në zbatimin e këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.242/2025

Çlirim Zeka

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit G.E.;
- Ministrisë së Punëve të Brendshme (Sekretares së Përgjithshme dhe Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore); si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.